


Aksidentet Rrugore*

Maj 2026

Në muajin maj 2026 janë regjistruar 133 aksidente rrugore, në të cilat 181 persona kanë mbetur të aksidentuar (të vrarë dhe të plagosur).

Gjatë periudhës janar-maj 2026, numri i aksidenteve rrugore ka pësuar rritje me 3,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

FIG. 1 AKSIDENTET RRUGORE DHE TË AKSIDENTUARIT (TË VRARË E TË PLAGOSUR), MAJ 2022 – MAJ 2026



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Gjatë muajit maj 2026, 94,0 % e aksidenteve rrugore kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve.

* Të dhënat e publikuara janë paraprake dhe subjekt përditësimi.

Grupmosha 25-34 vjeç paraqet numrin më të lartë të aksidenteve, duke përbërë 30,8 % të numrit total të aksidenteve të regjistruara në këtë periudhë.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore, sipas ditëve të javës, është shënuar ditën e dielë me 18,0 %, ndërsa numri më i ulët është regjistruar ditën e mërkurë me 12,0 %.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore është regjistruar përgjatë harkut kohor 08:00-12:00, duke përbërë 27,1 % të numrit total të aksidenteve rrugore.

TAB.1 AKSIDENTET RRUGORE, NUMRI I TË VDEKURVE DHE TË PLAGOSURVE, SIPAS QARQEVE

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur		Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Maj 2025	Maj 2026	Maj 2025	Maj 2026	Janar-Maj 2025	Janar-Maj 2026	Janar-Maj 2025	Janar-Maj 2026
Shqipëria	116	133	157	181	529	547	743	766
Berat	0	1	0	1	11	3	12	3
Dibër	4	4	9	7	11	7	30	12
Durrës	7	11	7	19	41	38	52	62
Elbasan	6	7	7	10	24	21	31	33
Fier	14	14	21	15	47	33	71	41
Gjirokastrë	8	5	9	8	31	20	48	40
Korçë	9	6	9	6	45	33	51	33
Kukës	3	3	3	5	15	18	24	27
Lezhë	15	11	21	19	65	60	103	111
Shkodër	13	7	16	9	51	29	66	37
Tiranë	30	53	38	69	157	235	209	290
Vlorë	7	11	17	13	31	50	46	77

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT-it, në seksionin: [Transporti, Aksidentet dhe Karakteristikat e Mjetet Rrugore](#)

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore, si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrin e personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore, të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend, duke i krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni që i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme, ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla, që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private, në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, dhe që rezulton në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person që ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, duke përfshirë rastet e vetëvrasjeve.

I plagosur: Çdo person që, si rezultat i një aksidenti, nuk është vrarë menjëherë ose nuk ka vdekur brenda 30 ditëve, por ka pësuar një dëmtim për të cilin ka lindur nevoja për trajtim mjekësor, duke përfshirë rastet e vetëvrasjeve në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor”, si: frenim i papritur, mosrespektim i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektim i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor”, si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Brendshme / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Të dhënat e muajit të fundit mbi personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë informacion, referojuni te Politika e Revizionimit Statistikor: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 - Vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse
- Pa vlerë
- (...) - Mungesë të dhënash